



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR VJOSË

Nr 2/5 Prot

Vlorë, më 09.01. 2023.

VENDIM

Nr. 17 , datë 28.12.2022

PËR

**MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR PËR
AKUAKULTURË, ME VENDNDODHJE: NJËSIA ADMINISTRATIVE CEPO,
BASHKIA GJIROKASTËR, QARKU GJIROKASTËR**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Vjosë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi ujor nëntokësor për akuakulturë (në rastin kur përdorimi është për >5ton/vit, >5l/sek), të subjektit “Dash- Peshk” sh.p.k me vendndodhje: Fshati Kardhiq, Njësia Administrative Cepo, Bashkia Gjirokastër, Qarku Gjirokastër.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:
Akuiferi që kërkohet të shfrytëzohet: Kuaternar
Koordinatat e vendndodhjes së burimeve (KRGJSH)
Burimi nr.1
X=503032.26 Y=4444881.50 Z=248 m.m.n.d
Q1= 25 l/sek (ky burim do të përdoret vetëm në rast se nuk plotësohet bilanci total i ujit Q=415 l/sek).
Burimi nr.2
X=503600.72 Y=4445016.89 Z=245 m.m.n.d Q2= 175 l/sek

Burimi nr.3

X=503897.8 Y=4445273.2 Z=232.5 m.m.n.d Q3= 240 l/sek

Koordinatat e pikës ku do të shfrytëzohet uji (KRGJSH)

X1=503980.2; Y1=4445261.6; Z1=232.17 m.m.n.d

X2=503994.1; Y2=4445269.7; Z2=232 m.m.n.d

X3=504017.9; Y3=4445290; Z3=231.74 m.m.n.d

X4=504030.8; Y4=4445298.1; Z4=231.72 m.m.n.d

Qëllimi i përdorimit të ujit: Për akuakulturë (rritje intensive e peshqve).

Sasia e ujit të kërkuar: Qtot= 415 l/sek (për të tre burimet)

Prurja mesatare vjetore: Qmes-vjet=700 l/sek (për të tre burimet)

Prurja ekologjike: Qek=165 l/sek (për të tre burimet)

Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH)

Pika 1: X=504058.5; Y=4445234.4; Z=225 m.m.n.d

Pika 2: X=504276.6; Y=4445410; Z=220 m.m.n.d

Prurja që shkarkohet: Q=415 l/s

Trupi uJOR pritës: Lumi i Kardhiqit

3.Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

4.Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

K R Y E T A R

ELAMUR MAMAJ



Elmur Mamaj